



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1
- 2
- 3
- 4
- 5

Kronikë

Tiranë/ Goditi me qytën e pistoletës një person në një lokal në 'Don Bosko', arrestohet 37-vjeçari (EMRAT+VIDEO)

Sipas dyshimeve të policisë, me këtë armë Kallari ka goditur në pjesën e ballit Arben Merkajn, duke përdorur qytën e pistoletës. Indrit Kallari është arrestuar në flagrancë dhe ndaj tij janë ngritur akuzat për veprat penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve” dhe “Plagosja e rëndë”.

Goditi me qytën e pistoletës një person në një lokal në Don Bosko, arr

Report TV



Watch on

Redaksia
25 Gusht, 13:21 | Përditësimi: 25 Gusht, 14:57

Share Post



Një ngjarje e rëndë kriminale është parandaluar mbrëmjen e 24 gushtit në zonën e Don Boskos, në [Tiranë](#), pas një konflikti mes disa personave në ambientet e një lokali. Rreth orës 21:45, shërbimet e Policisë janë njoftuar për një konflikt në rrugën “Eshref Frashëri”.

Pas marrjes së njoftimit, efektivët e Komisarariatit të Policisë Nr. 3, me Forcat “Shqiponja”, kanë ndërhyrë në vendngjarje, në ambientet e lokalit “Omerta”. Gjatë kontrollit fizik të ushtruar ndaj Indrit Kallarit, uniformat blu gjetën dhe sekuestruar një armë zjarri pistoletë, tip “TT”.

Sipas dyshimeve të policisë, me këtë armë Kallari ka goditur në pjesën e ballit Arben Merkajn, duke përdorur qytën e pistoletës. [Indrit Kallari](#) është arrestuar në flagrancë dhe ndaj tij janë ngritur akuzat për veprat penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve” dhe “Plagosja e rëndë”.



LEXO EDHE: Zjarr në malin e Dajtit në Tiranë, një avion në operacion për shuarjen e flakëve

Ndërkohë [Arben Merkaj](#) do të hetohet në gjendje të lirë për “Moskallëzimi i krimit”, pasi nuk ka kallëzuar rrethanat në të cilat ka ndodhur konflikti dhe plagosja. Policia ka sekuestruar edhe pajisjen DVR të lokalit “Omerta”, pamjet e së cilës pritet të ndihmojnë në dokumentimin dhe zbardhjen e plotë të dinamikës së ngjarjes.

Njoftimi i policisë:

Menjëherë pas njoftimit për një konflikt në rrugën “Eshref Frashëri”, ndërmjet 2 shtetasve, rreth orës 21:45 të datës 24.08.2026, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 3, në bashkëpunim me shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja”, organizuan punën dhe shkuan në vendngjarje, për të sqaruar rrethanat dhe përgjegjësitë në lidhje me këtë rast.

Si rezultat i veprimeve të shpejta hetimore dhe operacionale u neutralizua konflikti, si dhe u arrestua në flagrancë shtetasi I. K., 37 vjeç, banues në Krujë, i cili dyshohet se për motive të dobëta, ka goditur me qytën e armës së zjarrit (pistoletë) që mbante pa leje, shtetasin A. M., 47 vjeç, banues në Laprakë.

Në vijim të këtyre veprimeve nisi procedimi në gjendje të lirë për 47-vjeçarin, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

Xh.K/SI.E./Shqiptarja.com

TAG: [Tirane](#) [Indrit Kallari](#) [Arben Merkaj](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës: Si ju duket plani i qeverisjes i paraqitur në Pogradec nga Rama?

24 Gusht, 21:21

[Mirë](#) [Keq](#) [Nuk e di](#)

Lajme të tjera



Jakin Marena: ‘Vijat e kuqe’ të SHBA, opozita dhe revolucionet që s’ndezi as nga ‘Gaza’



[Jakin Marena](#)

25 Gusht, 19:10



Balla nxjerr pamje nga një vendgrumbullim mbetjesh në Spille: Bashkia Kavajë nuk merret me pastrimin! Do ndërhyjmë vetë, s’do presim Fisnikun

25 Gusht, 17:28



Gara për Tiranën/ Berisha: Primaret s’përgjashtohen! Alimehmeti, personalitet i shquar! Kandidatura e Braçes? Luftë e brendshme në PS

25 Gusht, 13:57



‘Territorialja’/ Demokratët kërkesë Këshillit Bashkiak: Nisni dëgjesat në Tiranë! Banorët e Klosit: Jo bashkim me Matin! PS e PD përplasen në Elbasan

25 Gusht, 13:19




Tiranë/ Kontroll në burgun ‘313’, të riut i gjenden 17 doza kokainë dhe 13 doza hashash

25 Gusht, 12:58




Tiranë/ Vodhën 2.5 milionë lekë në një banesë në Sharrë, 3 të arrestuar dhe një në kërkim! Sekuestrohet një ‘Maserati’ (VIDEO)

25 Gusht, 12:13




Përmirësohet situata me zjarret, vetëm 6 vatra aktive! Vijon operacioni në Malin e Dajtit, flakë edhe në Shashicë të Vlorës! ‘Qetësohet’ Puka

25 Gusht, 09:32



Vendoret 2027/ Braçe: Do t’i shkoj deri në fund garës për Tiranën! Kandidati i PS të mos vijë me ‘njoftim në mur’, socialistët duhet të zgjedhin (VIDEO)

25 Gusht, 08:19



Burri rreh me shkop gruan në mes të protestës, përfundon në Komisariat (VIDEO)

24 Gusht, 22:53



Ylli Pata: Fjalëkryqi politik i Tiranës



[Ylli Pata](#)

24 Gusht, 19:44



Mashtroi punonjësit në 2 biznese në Tiranë dhe vodhi një çantë brenda një tjetër subjekti, arrestohet 37-vjeçari (EMRI)

24 Gusht, 16:56



Videocall me imazhin e Bashkim Ulajt të krijuar me AI, si 3 të rinjtë në Tiranë mashtruan 70-vjeçarin kambist dhe i morën 100 mijë euro (VIDEO)

24 Gusht, 16:37



Lajmi i fundit



Zbulohet plani i BIA-s serbe për kompromentimin e Albin Kurtit, ja çfarë u gjet në telefonin e analistit të dyshuar për spiunazh!

25 Gusht, 21:42





GetButton

× **[Sh]** Lajmi i fundit



Zbulohet plani i BIA-s serbe për kompromentimin e Albin Kurtit, ja çfarë u gjet në telefonin e analistit të dyshuar për spiunazh!

25 Gusht, 21:42